REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E DREJTËSISË/MINISTARSTVO PRAVDE
MINISTRY OF JUSTICE
Nr.Br.No: 01-1356/2
Data/Datum/Date: 21/01/2025
Shtojca/Dodaci/Annex: -3-
PRISHTINË/A (2024)

# Republika e Kosovës

## Republika Kosova-Republic of Kosovo

### Qeveria -Vlada - Government

*Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice*

Kabineti i Ministres së Drejtësisë - Ured Ministra Pravde - Office of Minister of Justice

Nr. 17 /2025

Datë: 21/01/2025

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10, (paragrafi 1 dhe 2), dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (GZ, Nr.7/01 mars 2019), duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në përputhje me nenin 50 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në pajtim me Shtojcën 1 (pika 3) të Rregullores QRK-nr. 14/2023 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive, në pajtim me nenin 10 paragrafi 7 të Ligjit nr. 06/L-010 për Noterinë i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 08/L-272 dhe Ligjin nr. 08/L-149, Ministrja e Drejtësisë, nxjerr këtë:

**Korrigjimi i gabimeve të dukshme në një akt administrativ**

Duke u bazuar në nenin 50, të Ligjit Nr. 05/L-131 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, pika 1 e Vendimit Nr. 213/2024, i datës 15.7.2024 me të cilin Fatmire (Hisen) Dobruna është emëruar në detyrën e noterit, korrigjohet emërtimi i Komunës nga: "Komuna e Drenasit" në "Komuna e Gllogocit".

Albulena HAXHIU

Ministre e Drejtësisë

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E DREJTËSISË/MINISTARSTVO PRAVDE
MINISTRY OF JUSTICE
Nr.Br.No: 01-1356
Data/Datum/Date: 15/07/2024
Shtojca/Dodaci/Annex: -2-
PRISHTINË/A

Republika e Kosovës

Republika Kosova -Republic of Kosovo

*Qeveria -Vlada - Government*

*Ministria e Drejtësisë – Ministarstvo Prade – Ministry of Justice*

Kabineti i Ministres së Drejtësisë – Kancelarija Ministra Pravde – Cabinet of the Minister of Justice

Nr. 213/2024

Datë: 15/07/2024

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2) dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura, (GZ/Nr. 7/01 mars 2019), në bazë të nenit 11 (paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5) të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 10 (paragrafi 7) të Ligjit nr. 06/L-010 për Noterinë, i ndryshuar dhe plotësuar më Ligjin nr. 08/L-149, si dhe në përputhje me Shtojcën 1 (pika 3) të Rregullores QRK-nr. 14/2023 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive, Ministrja e Drejtësisë nxjerr këtë:

## VENDIM

1. Znj. Fatmire (Hisen) Dobruna, emërohet në detyrën e noterit në juridiksionin territorial të Komunës së Drenasit.

2. Në pajtim me nenin 20 (paragrafi 1 dhe 3) të Ligjit nr. 06/L-010 për Noterinë, obligohet e emëruara që brenda periudhës prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, ti ofrojë Ministrinë së Drejtësisë dëshminë përkatëse me të cilin vërteton dorëheqjen e saj nga funksioni aktual zyrtar.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

## Arsyetim

Pas propozimit të Komisionit për Zgjedhjen e Noterëve për kandidatët që i plotësojnë kushtet për të ushtruar funksionin dhe shërbimin noterial në Republikën e Kosovës, si dhe duke pas për bazë legjislacionin përkatës në fuqi për noterinë që rregullon këtë çështje, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Albulena HAXHIU

Ministre e Drejtësisë

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet konflikt administrativ në gjykatën kompetente në afat prej tridhjetë (30) ditësh.

Vendimi iu dërgohet:

- *Të emëruares Znj. Fatmire Dobruna;*
- *Sekretares së Përgjithshme/MD;*
- *Departamentit për Profesione të Lira/MD;*
- *Odës së Noterëve të Kosovës;*
- *Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.*